

ANALIZË SOCIOLOGJIKE E FESË, EDUKIMIT DHE FAMILJES: SHEMBULLI I ROLIT TË GRUAS NË ISLAM

Hyrje

Institucionet sociale janë baza kryesore e strukturës së shoqërisë. Ato nuk kontribuojnë vetëm në ndërtimin dhe funksionimin e shoqërisë, por edhe pasurojnë formën kulturore dhe elementët e saj, si dhe mundësojnë transmetimin e saj në shtirirje të gjera kohore. Për të arritur një analizë të suksesshme të shoqërisë (përbajtja, funksionet, zhvillimi historiko-kulturor, problemet, lidhjet midis institucioneve, strukturën etj.) është i domosdoshëm analizimi i institucioneve sociale. Nga qasje të ndryshme sociologjike, institucioni social është pjesë e kulturës, e cila reflekton nëpërmjet mënyrës së jetesës dhe përmbledh sjelljet që kanë shumë prej aktorëve socialë, rrugët që të çojnë drejt përmbushjes së normave dhe sjelljeve të kulturës. *“Për të realizuar një përcaktim disi më të përmbledhur të institucionit social, duhet të përmenden disa elemente që ai përmban në vetvete, siç janë:*

- Institucioni social ka si objektiv realizimin e qëllimit të tij;
- *Përgjatë historisë njerëzore, institucioni social i ka realizuar me sukses qëllimet e tij;*
- *Për realizimin e qëllimit, ka bashkëpunuar me institucione të tjera sociale;*
- *Pavarësisht bashkëpunimit, institucioni social ka strukturë të pavarur;*
- *Institucioni social në vetvete përmban kodet normative të kulturës të shoqërisë ku funksionon, si rrjedhojë merr një rëndësi të veçantë”¹.*

Në strukturën e shoqërisë ndodhen shtatë institucione kryesore sociale (megjithatë ky kategorizim ndryshon sipas kushteve të jetesës, kushteve gjeografike, rëndësisë që u jep shoqëria dhe funksioneve që mbartin) dhe shumë institucione të tjera emergjente, të cilat lindin dhe e zhvillojnë aktivitetin e tyre social, sipas kushteve sociale bashkëkohore. Shtatë institucionet kryesore sociale mund të radhiten kështu: familja, edukimi,

1 Aydin; 2000: 16.

ekonomia, politika (sistemi qeverisës), sistemi shëndetësor, sistemi ushtarak dhe feja. Pavarësisht se institucionet sociale mbartin funksione të ndryshme (siç janë të radhitura më poshtë), ato kanë ndërthurje të përbashkëta dhe funksionojnë në varësi të nevojave të shoqërisë. Për shembull, edukimi si institucion social, ndërthuret në funksionet e tij dhe me institucione të tjera sociale që kryejnë funksionin e edukimit, siç janë familja dhe feja.

Disa prej funksioneve kryesore të institucioneve sociale:

- Të lehtësojë sjelljet sociale të individit (i orienton individët drejt normave dhe rregullave social të rregullit social në shoqëri).
- I mundëson shoqërisë vazhdimësinë dhe qëndrueshmërinë e kulturës.
- Mundëson lokalizimin e devijimeve dhe anomalive sociale, nëpërmjet kontrollit të sjelljeve sociale, me qëllim të ruajtjes së rregullit social²

Bazuar në konceptin e institucioneve sociale, sipas perspektivës sociologjike, është shumë e rëndësishme të theksohet se mekanizmat e funksionimit të shoqërisë bazohen te institucionet. Nëse e analizojmë nga perspektiva strukturaliste-funksionaliste, shoqëria është si një organizëm i gjallë, i cili zhvillohet për të ruajtur rregullin social. Sipas Merton, disa prej strukturave sociale (Merton përfshin edhe institucionet sociale në këto struktura) kanë ndikim të dukshëm te përshtatja dhe sjelljet e duhura (sjellje konformiste) të individëve³. Ky lloj funksionimi njihet edhe si postulati i dytë i funksionalizmit universal, që përcaktohet si funksioni pozitiv. Pikërisht dhe ky artikull do të fokusohet te funksionalizimi universal pozitiv i bashkëpunimit të tri institucioneve sociale, që janë familja, edukimi dhe feja, për promovimin e solidaritetit social.

Bazuar në këto çështje është e rëndësishme të theksohet se feja ka një rol të rëndësishëm në mekanizmat për solidaritetin social, megjithatë ndonjëherë bëhet e pandashme nga konceptimi social i jetës shoqërore dhe kulturore. Kjo ndodh si shkak i procesit të edukimit (sidomos procesit të socializimit, ku aktori social përtej perceptimeve personale, i plotëson perceptimet sociale sipas strukturës sociale dhe kulturore të ambientit ku ai jeton.⁴

2 Aydin; 2000: 16.

3 Merton, 1983: 672 at Poloma, 1993: 36.

4 Likaj Shaqiri, 2017: 137.

Koncepti i rrjedhës së jetës, ndryshe prej ciklit të jetës, pasqyron se ekziston ndryshim i konsiderueshëm në shoqëritë e ndryshme në shtrirje kohore të gjata, që ndikojnë në jetën e individëve dhe perceptimet e tyre në jetën sociale. Rrjedha e jetës dhe fazat e ndryshme që paraqiten në ciklin e jetës, u mundësojnë individëve të jenë të hapur për pranimin e ndryshimeve kulturore dhe rrethanave materiale/jomateriale të jetës së tyre.⁵ Ndryshimet sociale, kulturore, ekonomike dhe politike ndikojnë në ndryshimin e strukturës sociale dhe institucioneve sociale që ajo mbart. Megjithatë, në strukturën sociale të një shoqërie, një vend shumë të rëndësishëm zë konsensusi social. Konsensusi nënkupton dakordësinë e individëve në vlerat bazë të shoqërisë, stabilitetin social, ruajtjen e kontrollit social etj. Familja, edukimi dhe feja janë institucionet sociale të cilët mundësojnë ruajtjen e konsensusit social të një shoqërie.

Pikërisht, fokusi i këtij punimi do të jetë te ndryshimet sociale, ndryshimet e rrjedhës së jetës dhe lidhja e tri institucioneve sociale, siç janë familja, edukimi dhe feja. Ndikimi reflektohet nëpërmjet roleve që mbart roli i individit edukues (në këtë rast, femra si nënë) dhe reflektimi i këtij roli në brezat e rinj.

Ky artikull do të zhvillohet duke u bazuar në trajtesat sociologjike të institucioneve sociale si edukimi, familja dhe feja, si dhe analizimi i rolit të guas në një ndër tri fetë kryesore, siç është Islami.

Edukimi, familja dhe feja si institucione sociale

Edukimi si socializim

Edukimi është një nga institucionet më të rëndësishme shoqërore në çdo shoqëri, e cila promovon dhe mundëson transmetimin e njohurive dhe aftësive nëpër gjenerata. Edukimi në vetvete ndahet sipas formave të tij, formal dhe joformal. Edukimi formal (i cili zhvillohet në institucione arsimore) u mundëson fëmijëve të përvetësojnë jo vetëm aftësi profesionale, por edhe rregullat shoqërore që kontribuojnë në funksionimin e shoqërisë. Sipas Durkheim, edukimi luan një rol të rëndësishëm në socializimin e fëmijëve, sepse fëmijët fitojnë aftësi për të kuptuar vlerat e përbashkëta në shoqëri, duke bashkuar një mori individësh të veçantë. Edukimi joformal, që njihet dhe si procesi i socializimit, fillon në familje (si institucion social) dhe e ka vazhdimësinë deri në fund të jetës së individit. Gjatë këtij

5 Giddens, 2009: 295.

procesi, aktori social mëson rregullat kryesore të familjes, rreth mënyrës së organizimit të jetës si dhe marrjen si shembull të modeleve kryesore të pjesëtarëve të saj, veçanërisht të prindërve. Kështu që Durkheim fokusohet te roli i edukimit si institucion social, në përgatitjen e fëmijëve si aktorë socialë. Edukimi luan një rol shumë të rëndësishëm në socializimin e fëmijëve, për t'i përgatitur për rolin që ata do kenë në shoqëri, për të mësuar solidaritetin dhe vlerat kulturore. *“Për Emile Durkheim, edukimi luan një rol të rëndësishëm në socializimin e fëmijëve, për shembull, fëmijët fitojnë një kuptim të vlerave të përbashkëta në shoqëri, duke bashkuar një mori perceptimesh individuale dhe të veçanta. Këto vlera të përbashkëta përfshijnë besimet fetare dhe morale, si dhe ndjenjën e vetëdisiplinës”*.⁶ Edukimi në vetvete ndahet në dy forma, formal dhe joformal. Edukimi formal është i planifikuar dhe realizohet në institucione formale në shoqëri. Ndërsa edukimi joformal, ndryshe i njohur si socializim realizohet si rrjedhojë e ndikimit të institucioneve sociale, siç janë familja, feja etj. Socializimi nënkupton veprim sistematik dhe të qëllimshëm, i cili e orienton individin drejt vlerave dhe strukturimit të roleve në të ardhmen si i rritur. *“Sipas Parson socializimi është proces i brendshëm i orientimeve përkatëse, për plotësimin e pritshmërive të shoqërisë. Ndryshe prej Parson, Durkheim e cilëson socializimin si ruajtës të qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë së shoqërisë”*.⁷

Sipas sociologëve, socializimi është procesi në të cilin fëmija gradualisht bëhet një person i vetëdijshëm, i ditur, i aftë për përvetësimin e elementëve të kulturës ku jeton. Socializimi i të rinjve formon fenomenin më të përgjithshëm të riprodhimit social, proces ku shoqëritë përvetësojnë vazhdimësi të strukturës socio-kulturore. Gjatë rrjedhës së socializimit, sidomos në vitet e hershme të jetës, fëmijët mësojnë vlerat, normat dhe praktikatat e tyre shoqërore.⁸ Ndërveprimet sociale e kanë bazën e zhvillimit në institucionin social, siç është familja.

Familja si institucion social

Në procesin e shoqërizimit/socializimit, mjedisi i parë social i individit është familja. Familja është ambienti social ku individit përballet me mënyrën e jetesës dhe me vlerat që ajo ka. Gjatë procesit të socializimit, familja është institucioni themelor shoqëror si mjedisi i parë social, në të

6 Giddens, 2009: 834.

7 Zenelaga dhe Cenaj, 2012: 45.

8 Giddens, 2009: 285.

cilin fëmija përvetëson vlerat e shoqërisë dhe zakonet e jetës. Vlerat (ose gjykimet e vlerës) dhe normat (p.sh. normat morale) më të larta të shoqërisë ku jeton, i përcillen fëmijës për herë të parë në familje. Familja nuk ndikon vetëm në formimin e personalitetit të individit, por njëkohësisht i mëson individit vlerat, normat, traditat, zakonet etj., të shoqërisë dhe strukturës socio-kulturore të saj. E shprehur me fjalë të tjera, familja ka rëndësi të madhe në përcjelljen e kulturës, vlerave, normave, traditave, zakoneve të brezat e rinj. Mësimi i rregullave të shoqërisë, vlerave dhe përvetësimit të gjykimet të vlerave prej një të riu, e ndihmojnë atë në formimin e një stili jetese që është i përshtatshëm me shoqërinë ku ai jeton. Kjo e ndihmon të riun të konsiderohet si anëtar i kësaj shoqërie, si dhe të bëhet pjesë e mekanizmit të ruajtjes dhe transmetimit të këtyre elementëve në brezat e ardhshëm. Në këtë rast, i riu luan një rol aktiv në vazhdimësinë e kulturës dhe elementëve të saj, në mënyrë që të transmetohen nga brezi në brez. Siç duket, funksioni kryesor i familjes është që të sigurojë përfshirjen e fëmijës në socializim dhe në përvetësimin e funksioneve të kulturës.

“Familja është një grup personash që kanë lidhje gjaku ose martesore, ku të rritur kanë si detyrë kryesore dhe përgjegjësinë e përkujdesjes ndaj fëmijëve.⁹ Familja i organizon detyrat familjare në mënyrë tepër individuale, si dhe mundëson lidhjen e kësaj hapësire me një ambient më të gjerë social”.¹⁰

“Në të gjitha shoqëritë, familja është vendi i parë dhe më i rëndësishëm për socializim (një agjent i socializimit). Familja në të cilën ne lindim, na jep karakteristika sociale të tilla si klasa sociale, raca, etnia dhe prejardhja fetare. Familjet tona janë mësuesit tanë fillestarë të sjelljeve, gjubës, njohurive kulturore, vlerave dhe aftësive sociale. Ato janë gjithashtu qendrore për rolin gjinor, socializimin. Me fjalë të tjera, familja siguron socializimin tonë primar”.¹¹ Për rrjedhojë, mund të thuhet se familja gëzon dy role kryesore, vazhdimësinë e brezave dhe formimin e sistemit të standardizimit, duke u bazuar në kushtet sociale dhe kulturore të shoqërisë ku ndodhen. “Familja, si një institucion social, ka si funksione vazhdimësinë e brezave, transmetimin e kulturës kombëtare dhe fetare, socializimin e fëmijëve, plotësimin e nevojave ekonomike, biologjike dhe psikologjike”.¹² Nisur prej këtyre funksioneve dhe bazuar te Mead, është e rëndësishme të theksohet se individi formon vetveten sociale (social self) dhe koshiençën sociale (social consciousness). Ambienti ku aktori social e realizon vetveten sociale, është institucioni

9 Giddens, 2009: 331.

10 Giddens, 2009: 339.

11 Spickard, 1992: 145.

12 Aydin, 2000: 35.

i familjes. Nëpërmjet ndërveprimeve sociale në familje formohet edhe riprodhimi kulturor.

*“Bourdieu përdor konceptin e riprodhimit kulturor, duke marrë parasysh vlerën themelore, siç është “habitus”, e cila mund të përshkruhet si sjellje, mënyra e të folurit ose mënyra e të menduarit dhe mënyra e të vepruarit. Këto sjellje miratohen nga aktorë të tjerë socialë, që gjenden në të njëjtat kushtet shoqërore”.*¹³ Këta aktorë socialë janë pjesëtarët e familjes, prindërit (sidomos nënat), motrat dhe vëllezërit, si dhe farefisi shumë i afërt

Feja si institucion social

*“Fetë e mëdha ndikojnë fuqishëm tek individit”.*¹⁴ Ndoshta, Freyer ka qenë i ndikuar prej filozofisë së Hume, ku feja ndikon në formimin e shpresës dhe të frikës së individit. Nëse, sipas Freyer, feja ka ndikim kaq të madh tek individit (kjo është relative dhe shumë e diskutueshme), atëherë bëhet i detyrueshëm përcaktimi sociologjik i konceptit dhe i praktikës së fesë (shkurtimisht).

Sociologët e përcaktojnë fenë si një sistem kulturor të besimeve dhe ritualeve të përbashkëta, që sigurojnë një ndjenjë të kuptimit dhe qëllimit përfundimtar, duke krijuar një ide të realitetit që është i shenjtë, gjithëpërfshirës dhe mbinatyror.

“Feja është një formë e kulturës. Kultura përbëhet nga besimet, vlerat, normat dhe idetë e përbashkëta që krijojnë një identitet të përbashkët në mesin e një grupi njerëzish. Feja i përmban të gjitha këto karakteristika.

Feja përfshin besime që marrin formën e praktikave të ritualizuara. Të gjitha fetë kanë një aktivitet të veçantë dhe sistem sjelljesh, në të cilin besimtarët marrin pjesë dhe që i identifikojnë si anëtarë të bashkësisë fetare.

*Ndoshta më e rëndësishmja është që feja siguron një ndjenjë qëllimi – një ndjenjë që, në fund të fundit, jeta është kuptimplotë. Kjo i mundëson shpjegim në mënyrë koherente dhe bindëse atë që tejkalon ose lëkund jetën e përditshme, në mënyrën ndryshe prej aspekteve të tjera të kulturës (si sistemi arsimor ose besimi në demokraci)”.*¹⁵

Feja në vetvete (përveç përcaktimit sociologjik të sipërpërmendur) ka një lidhje të fortë me shoqërinë, grupet sociale ose komunitetet. Si një fenomen social, reflektimet dhe ndikimet e saj janë indikatorë (tregues)

13 Likaj Shaqiri, 2017: 4.

14 Freyer, 2015: 108.

15 Giddens, 2009: 677.

në jetën shoqërore dhe strukturën sociale. Feja, si të gjitha institucionet e tjera sociale, ka funksionet e saj. Këto funksione janë të lidhura ngushtë me funksionet e institucioneve të tjera sociale. Funksionet sociale të fesë nuk mund të operojnë të pavarura prej institucioneve sociale dhe strukturës shoqërore, megjithatë ato ndryshojnë nga një vend në tjetrin. *“Parsons supozon se feja ka disa funksione në shoqëri. Së pari, ndihmon anëtarët e shoqërisë për t'u marrë me ngjarje të paparashikueshme dhe të pakontrollueshme, siç është vdekja e hershme. Së dyti, nëpërmjet riteve, feja u mundëson individëve të jetojnë me pasigurinë. Feja i jep kuptim jetës dhe shpjegon fenomenet që ndryshe do të duken të pakuptimta, siç është vuajtja dhe problemi i së keqes. Në këtë mënyrë, ajo zbut tensione që përndryshe do të shqetësonin rendin shoqëror dhe ndihmon në ruajtjen e stabilitetit shoqëror”*.¹⁶

Kështu që, feja si institucion social, jo vetëm që luan një rol stabilizues tek aktori social, (kjo nuk mund të jetë absolute në të gjitha fetë) por ndikon në ndërveprimin social dhe formimin e “habitus” (termi i përdorur prej Habermas) me institucione të tjera sociale (në këtë rast janë familja dhe edukimi). *“Gjithashtu, Parsons e përcakton fenë shumë të rëndësishme jo vetëm për solidaritetin personal, por edhe për rendin dhe solidaritetin shoqëror”*.¹⁷

Në përgjithësi, të gjitha fetë përmbajnë besime, rituale, formimin e komuniteteve, rregulla, norma etj. Duke qenë se feja është sa personale, aq edhe shoqërore, transmetimi në breza i këtyre elementëve është pjesë e natyrshme e mënyrës së jetesës, por edhe e procesit të socializimit. Si fillim, familja është institucioni kryesor që e kryen këtë detyrim. Në vazhdimësinë e këtij punimi do të flitet për transmetimin e elementëve të fesë në familje, sidomos fokusi do të jetë te gruaja si nënë, gjatë procesit të prindërimit dhe edukimit.

Këndvështrim sociologjik i rolit të gruas në fenë islame

Vlerat, qëllimet dhe normat e shoqërisë dhe mjetet e institucionalizuara të krijuara prej strukturës sociale, përvetësohen gjatë procesit të socializimit dhe shpeshherë përdoren prej individëve gjatë jetës së tyre. Socializimi është burimi i parë i fitimit dhe i përvetësimit të vlerave të individit, proces ky i cili në fillim zhvillohet në familje. Në socializimin e fëmijës, rol shumë të rëndësishëm luajnë nëna, babai, motrat, vëllezërit, gjyshërit, të afërmit

16 Likaj Shaqiri, 2017: 135.

17 Likaj Shaqiri dhe Aydemir, 2013: 24.

etj. Gruaja, si nënë, luan një rol shumë të rëndësishëm gjatë procesit të socializimit, por edhe gjatë gjithë jetës së individit. Në familje, prindërit, vëllezërit e motrat, i transmetojnë individit, disa forma të sjelljes, vlerave themelore dhe normave të shoqërisë. Roli më i rëndësishëm në periudhën e socializimit të fëmijës i përket nënës.¹⁸

Roli i gruas si nënë, është shumë mbizotërues dhe ndikues tek edukimi i fëmijës. Fëmijët nuk gjenden vetëm nën ndikimin e tyre si individë me personalitete të ndryshme, por ndikohen prej tyre si aktorë socialë që mbartin dhe përfaqësojnë zakonet, traditat, vlerat sociale dhe kulturore etj., të shoqërisë ku jetojnë. Këtu përfshihen edhe format e ndryshme të fesë, elementet, ritualet, besimet etj. *“Besimet dhe vlerat e përfaqësuara nga të rriturit, që në këtë rast janë nënat dhe baballarët, gjatë periudhës së socializimit i transmetojnë ato tek individë duke ndikuar edhe tek super-egoja e tij”*.¹⁹ Për këtë arsye përvetësimi i normave dhe i vlerave janë pjesë e procesit të shoqërizimit/socializimit. Përtej mësimit të vlerave, përparësi merr mësimi i funksionimit të shoqërisë, e cila në mënyrë indirekte i mëson vlerat sociale dhe kulturore një individit.²⁰ Si rrjedhojë, socializimi është periudhë shumë e rëndësishme, e cila i mundëson fëmijës të përvetësojë në mënyrë koshiente ose jokoshiente, elementë të strukturës sociale dhe kulturore. Përvetësimi i këtyre elementëve mundëson vazhdimësinë e kulturës së vendit të origjinës së individit, të praktikave fetare dhe të fesë, që ai i përket.

“Edukimi i vërtetë unik arrihet nëpërmjet stimulimit të forcave të fëmijës, me anë të kërkesave të situatave shoqërore në të cilat ai do të gjendet”.²¹

“Njerëzit krijojnë ndërveprimeve shoqërore. Ndërsa ndërveprojmë me të tjerët, ne vazhdimisht flasim, dëgjojmë, vëzhgojmë, vlerësojmë dhe gjykojmë situatat, bazuar në mënyrën se si jemi shoqëruar për të kuptuar dhe reaguar ndaj tyre. Nëpërmjet këtij procesi të vazhdueshëm të perceptimit dhe përcaktimit të ngjarjeve, ne “interpretuojmë” realitetin dhe “e negociojmë” kuptimin”.²² Individët formojnë një realitet social që ka nevojë për t’u përvetësuar në dobi të individëve të tjerë dhe të shoqërisë. Këtë funksion të edukimit e luan gruaja, nëpërmjet rolit të prindërimit. Në këtë kontekst, vihet re ndërthurja që kanë me njëra – tjetrën institucionet sociale si familja, edukimi dhe feja. *“Feja në vetvete është produkti i mjedisit socio-kulturor.*

18 Taşdelen 2000; në: Özensel, 2004: 33.

19 Güngör, 2000: 58.

20 Güngör, 2000: 70.

21 Dewey, 2003: 11.

22 Stolley, 2005: 69.

Feja nuk është mbinjerëzore, por hyjnore. Struktura e fesë islame është rezultati i kushteve sociale që prodhon shoqëria. Shoqëria si determinuese (përcaktuese) e të gjithë përbërësve shoqërorë, qofshin ata materialë ose shpirtërorë, ndikon në riprodhimin e vetvetes”.²³

Edhe B. Turner, e përcakton Islamin si një sistem besimi dhe prodhim të strukturës socio-kulturore. Ky prodhim nuk është rastësi, por vjen natyrshëm nëpërmjet procesit të socializimit dhe rolit të gruas në transmetimin e këtij sistemi te brezat e rinj. Roli i gruas në fenë islame zë një vend shumë të rëndësishëm.

Në Kuran dhe hadithe, shpesh trajtohen barazia e burrave dhe e grave. Në ajetet rreth krijimit të njeriut, nuk është përcaktuar asnjë virtut për dallimin gjinor të burrave dhe grave. Gratë janë para së gjithash qenie njerëzore dhe kanë shumë të drejta themelore, veçanërisht mbizotëron e drejta për të jetuar në mënyrë të denjë dhe të japin kontributin e tyre në shoqëri.²⁴ Duke qenë se gruaja ka një rol të rëndësishëm dhe të barabartë me burrin, ajo mund të jetë modeli më i mirë edukues për fëmijët. *“Urdhëresat e Kuranit janë jodiskriminuese mes burrave dhe grave, ku 750 ajetet që flasin për shkencën, adresojnë burrat dhe gratë, pa bërë dallim. Profeti i Islamit, Muhamedi (a.s.), është një profet i dërguar për të gjithë njerëzit, që i ka këshilluar dhe udhëzuar burrin dhe gruan se si të edukojnë brezat e rinj”.²⁵*

Kjo tregon qartë mbështetjen dhe promovimin e veprimtarisë së gruas si në ambientin familjar, ashtu edhe në hapësirën publike. *“Një nga të drejtat që Islami ua jep grave, është fakti se u ka siguruar të ruajnë personalitetin e tyre. Gruaja ka të drejtën të shprehë atë që ajo mendon, duke përdorur plotësisht vullnetin e lirë. Profeti Muhamed (a.s.) është shprehur se gruaja, e cila nuk e ka izoluar veten nga jeta e shoqërisë, ka treguar se ajo është një individ me personalitet që mbron veten dhe të drejtat e saj”.²⁶* Gruaja në këtë rast mund të vlerësohet si aktor social po aq aktiv sa një burrë, megjithatë nuk duhet harruar dhe roli i saj si nënë. *“Në fakt, nëna është konsideruar të jetë mësuesi i parë i fesë dhe babai edukatori i parë. Për këtë arsye, është e sigurt se prindërit kanë ndikimin më të rëndësishëm në edukimin e fëmijës, duke praktikuar parimet e fesë. Metoda më ideale në edukimin fetar është “të mësosh fëmijën të adhurojë, të adhurojë së bashku me prindërit dhe të shpjegojë çështjet e fesë nëpërmjet bisedimeve”.²⁷*

23 Pajaziti, 2012: 69.

24 Gürhan, 2010: 71.

25 Kayadibi, __: 25).

26 Gürhan, 2010: 74.

27 Ay, 2005: 374.

Shkurtimisht, gruaja në Islam, jo vetëm që ka një rol shumë të rëndësishëm në hapësirën publike, por është aktori kryesor social që ndikon nëpërmjet ndërveprimit social dhe paraqitjes së modelit prindëror te brezat e rinj. Në periudhën e socializimit parësor, por edhe dytësor, gruaja si nënë është transmetuesi kryesor i vlerave të besimit fetar, modelit fetar, por edhe praktikës fetare të fëmijët.

Përfundim

Durkheim besonte se funksionimi i institucioneve sociale kishte si fokus promovimin dhe ruajtjen e kohezionit dhe unitetit social. Ndërveprimi midis institucioneve sociale është i pashmangshëm dhe gjendet në të gjitha shoqëritë (këtu duhet të theksohet se çdo periudhë kohore dhe çdo strukturë sociale ka ndryshim në ndërveprimet midis institucioneve sociale. Megjithatë, siç u diskutua më sipër, institucionet sociale si familja, edukimi dhe feja kanë një lidhje të fortë midis njëra – tjetrës. Nëpërmjet procesit të socializimit (proces shumë i rëndësishëm në institucionin social të edukimit), fëmijët mësojnë në familje se si të marrin modele të caktuar fetare, mësojnë vlerat, normat, rregullat dhe besimet fetare. Rëndësia e familjes ndaj fëmijës nuk është vetëm për shkak të nevojave financiare dhe materiale që ata kanë. Nevojat materiale të fëmijës mund të plotësohen në mënyra të ndryshme. Megjithatë, është shumë e vështirë të sigurohet një mjedis emocional dashurie dhe besimi në vende të tjera, larg familjes. Sidomos për fëmijët, dashuria e nënës është shumë e rëndësishme. Mungesa e dashurisë së nënës përcillet me sjellje të paqëndrueshme psikologjike të fëmija (të cilat e shoqërojnë gjatë gjithë jetës).²⁸

Kështu që rolin kryesor në periudhën e socializimit e kryen më së shumti nëna. *“Përveç rëndësisë psikologjike, pedagogjike dhe sociologjike të familjes, gjithashtu dihet se familja është faktori më i rëndësishëm në transmetimin e fesë të fëmijët”.*²⁹ Si përfundim, në këtë studim me qasje të analizës deskriptive, është e rëndësishme të nxirret si konkluzion, se feja si institucion social, merr forma të ndryshme sipas kushteve shoqërore. Nëse orientimet e shpjegimeve sociologjike deskriptive do të orientohen te praktika sociale, atëherë do të ngrihen polemika dhe dilema të shumta, të cilat do formojnë debate mbi këtë temë. Nëse, analiza sociologjike deskriptive do të analizohet duke u bazuar te literatura bazë teologjike e

²⁸ Aydin, 2003: 127.

²⁹ Aydin, 2005: 374.

fesë islame, do të vihët re se institucionet sociale edukim-familje-fe kanë një lidhje shumë të fortë me njëra-tjetrën, por do të dallohet se roli i femrës, si grua dhe si nënë, është mbizotërues dhe shumë ndikues.

Bibliografia

1. AY, Mehmet Emin, “*Ailede Verilecek Din Egitiminde Genel Prensipler: Islamda Aile Vè Çocuk Terbiyesi*”, Karmat Yayın Evi, İstanbul, 2005.
2. Aydin, Mehmet Zeki, “*Ailede Ahlak Egitimi*”, Cumhuriyet Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Dergisi, vol: VII, pp.125-158, Sivas, 2003.
3. Aydin, Mustafa, “*Kurumlar Sosyolojisi*”; 2nci Baski; Vadi yayinlari, Konya, 2000.
4. Dewey, John, “*Shkolla dhe shoqëria*”, Përkth: A. Bubesi; “Plejada”, Tiranë, 2003.
5. Freyer, Hans, “*Sociologjia e Fesë*”, Përkth: A. Pajaziti, “Logos-A”, Shkup, 2015.
6. Giddens, Anthony, *Sociology*, 6th Edition; Polity Press: UK, 2009.
7. Güngör, Erol, “*Değerler Psikolojisi Üzerinde Araştırmalar, Ahlak Psikolojisi, Ahlaki Değerler ve Ahlaki Gelişme*”; Ötügen yayınevi, İstanbul, 2000.
8. Gürhan, Nazife, “*Toplumsal Cinsiyet Vè Din*”; e-Şarkiyat İlmi Araştırmalar Dergisi, vol IV, pp. 58-80, 2010.
9. Kayadibi, Fahri, “*Kadin Eğitiminin Önemi ve Kalkınmadaki Rolü*”, <http://dergipark.gov.tr/download/article-file/101022>, pp 19-31.
10. Likaj Shaqiri, M. dhe Aydemir, M. A., “*Religion and Spirituality as Important Issues on Social Capital: Albanian Society Case*”; BJH; vol. 2; pp 21-35, 2013.
11. Likaj Shaqiri, Matilda, “*Hermeneutics as the Interpretation of Religion in Cultural Context: Sociological Perspective of Albanian Culture*”; BJES, vol 14, number 1; pp 131-142, 2017.
12. Likaj Shaqiri, Matilda, “*Social Conflicts, Violent Extremism and Education: How to Combat ‘Hate Speech’ Through Counter And Alternative Narratives*”, BJES, vol. 15-16, pp. 1-16, 2017.
13. Özensel, Ertan, “*Türk Gençliğinin Değeri (Liseli Gençlik Üzerine Bir Araştırma)*”; Yayınlamamış Doktora Tezi, Sakarya, 2004.
14. Pajaziti, Ali, “*Një Interpretim Sociologjik i Religionit dhe Islamit: Rasti W.M. Watt*”, “Logos-A”: Shkup, 2012.
15. Poloma, Margaret, “*Çagdas Sosyoloji Kuramlari*”; cev: H. Erbas;

2nci Baski; Gundogan Yayinlari, Ankara, 1993.

16. Spickard, James V., “*For a Sociology of Experience*”, University of Redlands, *The Journal for Near-Death Studies*, vol. 3, no. 2, pp. 137-155, 1992.
17. Stolley, Kathy S., “*The Basics Of Sociology*”, Greenwood Press: London, 2005.
18. Zenelaga, B. dhe Cenaj, E., “Manual për Kursin Sociologji Edukimi”; “Mirgeeralb”, Tiranë, 2012.